



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 25 datë 17.12. 2025

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BASHKISË
PËRMET DHE FSHF-SË, MIRATIMIN E FINANCIMIT TE FSHF-SË PËR
RIKONSTRUKSIONIN E PJESSHËM TË STADIUMIT "DURIM QYPI", PËRMET SI DHE
DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË KRYETARIT TË BASHKISË PËR NËNSHKRIMIN E SAJ**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit Nr. 44 datë 30.04.2015 të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr. 8750, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit Nr. 1 0296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Ligjit Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit Nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, VKB Nr.17 datë 18.02.2025 për disa shtesa në VKB 107 datë 18.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Përmet viti 2025", si dhe bazuar në relacionin e paraqitur e me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Përmet dhe FSHF-së me objekt bashkëpunimin e palëve për realizimin e projektit për rikonstruksionin e pjesshëm të stadiumit Durim Qypi, Përmet.
2. Rikonstruksioni i pjesshëm i stadiumit në total do të arrijë vlerën 55 556 528.22 (pesëdhjetë e pesë million e pesëqind e pesëdhjetë e gjatë mijë e pesëqind e njëzetë e tetë pikë njezetë e dy) lekë me TVSH. Kjo vlerë do të bashkëfinancohet masën 50% FSHF dhe 50% Bashkia Përmet , 27 778 264.11 (njëzetë e shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër pikë njëmbëdhjetë) lekë nga të ardhurat e Bashkisë dhe 27 778 264.11 (njëzetë e shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër pikë njëmbëdhjetë) lekë nga Federata Shqiptare e Futbollit. Vlera e financimit nga Bashkia Përmet do të shtrihet në një afat kohor për dy vjet, 2026 dhe 2027.
3. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit, Sektorit Juridik e Prokurimeve, Drejtoria e Buxhet-Financë, Taksa Tregje dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësi, Turizëm.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR
Anila DHIMITRI





DRAFT MARRËVESHJE
PËR RIKONSTRUKSIONIN E PJESSHËM TË STADIUMIT "DURIM QYPI", PËRMET

Tiranë, më _____.202_

Ndërmjet palëve :

Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF), person juridik shqiptar, me seli në Tiranë, Rruga "Liman Kaba", Nr.5, Tiranë, identifikuar me NIPT: J62008031T e përfaqësuar nga **Sekretari i Përgjithshëm Z. Ilir Shulku** (në vijim referuar si "FSHF").

dhe

Bashkia Përmet, person juridik me NIPT K49719214P me adresë Sheshi "Abdyl Frashëri" përfaqësuar nga **Kryetare e Bashkisë Zj. Alma HOXHA** në vijim referuar si "Bashkia".

Bazuar në vendimin e Komitetit Ekzekutiv Nr.60 datë 28 prill 2025 për rikonstruksionin e pjesshëm të stadiumit 'Durim Qypi', Përmet dhe duke qënë se të dyja palët dëshirojnë të bashkëpunojnë për ekzekutimin e këtij projekti, nënshkruhet kjo marrëveshje si më poshtë:

Neni 1

Baza Ligjore

Kjo kontratë është hartuar bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjin Nr. 79/2017 "Për sportin", i ndryshuar, Ligji Nr.7850/1994 "Kodi civil i RSH", i ndryshuar, Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar.

Neni 2

Qëllimi i Kontratës

Qëllimi i kësaj kontrate është përcaktimi i kushteve dhe termave me anë të të cilave FSHF dhe Bashkia Përmet do të bashkëpunojnë për rikonstruksionin e pjesshëm të stadiumit "Durim Qypi", Përmet.

Neni 3

Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj kontrate është bashkëpunimi i palëve për realizimin e projektit për rikonstruksionin e pjesshëm të stadiumit Durim Qypi, Përmet.

Të gjitha punimet do të kryhen në bazë të projektit të miratuar.

Projekti përfshin punime të tilla si:

- Punime betoni
- Punime drenazhimi



- Punime për shtresat e fushës
- Instalimi i sistemeve, portave dhe paisjeve të mirëmbajtjes,
- Rikonstruksioni i bazamentit të fushës dhe sistemeve përreth saj,
- Të gjitha punimet e tjera sipas preventivit bashkëlidhur marrëveshjes.

Neni 4

Vlera Totale e Projektit dhe Kontributet financiare

1. Vlera totale e projektit do të jetë **55 556 528.22** (pesëdhjetë e pesë million e pesëqind e pesëdhjetë e gjatë mijë e pesëqind e njëzetë e tetë pikë njezetë e dy) lekë me TVSH.
2. Pavarësisht shumës së dakortësuar dhe të përcaktuar si vlerë fillestare e projektit palët duhet të bien dakord për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës, të volumeve të punimeve dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Punimet e ndryshuara duhet të materializojnë amendamentet e marrëveshjes, pasi të jenë miratuar me shkrim.
3. Projekti do të realizohet me bashkëfinancim në masën 50% FSHF dhe 50% Bashkia Përmet.
4. Kontributi i bashkisë:

a) Bashkia do të kontribuojë në vlerën **27 778 264.11** (njëzetë e shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër pikë njëmbëdhjetë) lekë sipas kështevës të parashikuara për 2 vite. Kjo vlerë do të disbursohet në llogarinë e FSHF në dy vite 2026 dhe 2027 në vlerat përkatëse si më poshtë:

- Kontributi i Bashkisë Përmet për vitin 2026 do të jetë **9 913 000** (nëntë milionë e nëntëqind e trembëdhjetë mijë) lekë dhe do të justifikohet me situacionet e punimeve të realizuara.
- Kontributi i Bashkisë Përmet për vitin 2027 do të jetë sa diferenca e gjysmës së situacionit përfundimtar të punimeve duke zbritur shumën e likujduar në vitin 2026, por jo më shumë se **27 778 264.11** (njëzetë e shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër pikë njëmbëdhjetë) lekë e cila përkon me vlerën takuese të llogaritur në bazë të preventivit fillestar.
- Likujdimi i kështit të dytë do të kryhet pas miratimit të situacionit përfundimtar të punimeve të realizuara.
- Në vlerat e sipërpërmendura përfshihen supervizioni & kolaudimi i punimeve.

b) Kontributi i FSHF-së:

- FSHF do të kontribuojë në vlerën **27 778 264.11** (njëzetë e shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër pikë njëmbëdhjetë) lekë.



Neni 5 **Angazhimet e Palëve**

5.1 Të drejtat dhe detyrimet e FSHF

FSHF do të jetë përgjegjëse për realizimin e punimeve që lidhen me projektin, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Kryerjen e procedurave të prokurimit për përzgjedhjen e kontraktorëve dhe furnitorëve.
- Mbikqytjen e punimeve për të siguruar pajtueshmërinë me specifikimet dhe standartet teknike. (Përcaktimin dhe likuidimin e mbikqyrësit të punimeve për këtë objekt).
- Kolaudimin përfundimtar të punimeve. (Përcaktimin dhe likuidimin e kolaudatorit të punimeve për këtë objekt).
- Realizimin e opionencës teknike si dhe detyrimet financiare që rrjedhin në bazë të VKM-së Nr.9 datë 11.01.2024 "Për miratimin e rregullave për projektet që duhet ti nënshtrohen opionencës teknike sipas secilës fushë projektimi si dhe procedurat që ndiqen në këto raste.
- Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis VNM dhe miratimi i saj.
- Menaxhimin e buxhetit të projektit.

5.2 Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Përmet

Bashkia do të jetë përgjegjëse për:

- Disbursimin e fondeve në formë granti, në llogarinë bankare të FSHF, sipas afateve kohore të përcaktuara .
- Bashkia nëpërmjet kësaj akt-marrëveshje merr përsipër rolin e bashkëzhvilluesit dhe në bazë të ligjit përjashtohet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.
- Miratimin e marrëveshjes në Këshillin Bashkiak.
- Lejen e ndërtimit për këtë objekt.
- Përdorimin pa pagesë të stadiumit kundrejt FSHF, për aktivitete futbolistike të ndryshme.
- Mirëmbajtjen ose punimet e strukturave të stadiumit, që bëhen të nevojshme në çfarëdo lloj momenti pas përfundimit të punimeve dhe /apo gjatë tyre, për çfarëdo lloj arsyeje qoftë kjo një forcë madhore, gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje.

Neni 6 **Menaxhimi i Projektit dhe Raportimi**

1. Me nënshkrimin kësaj marrëveshje, FSHF do të angazhojë sektorin e projekteve për të mbikqyrur ecurinë e projektit.
2. FSHF do t'i sigurojë Bashkisë raporte të rregullta të progresit, të paktën çdo tre mujor.



Neni 7 Deklaratat dhe Garancitë

1. FSHF deklaron dhe garanton se ka autoritetin e plotë për të hyrë në këtë kontratë dhe për të përmbushur detyrimin e saj sipas kësaj kontrate.
2. Bashkia deklaron dhe garanton se ka siguruar miratimet e nevojshme nga Këshilli Bashkiak për të hyrë në këtë kontratë dhe për të alokuar fondet e kërkuara sipas afateve të përcaktuara më sipër.

Neni 8 Forca Madhore

Asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë dështim në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nëse ky dështim shkaktohet nga ngjarje të forcës madhore, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në: luftë, grevë, bllokim ose ndonjë ngjarje tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të palës (Nje Ngjarje e Forcës së Madhore). Pala e prekur do të njoftojë palën tjetër për Ngjarjen e Forcës Madhore sa më shpejtë të jetë e mundur.

Neni 9 Sigurimi

FSHF do të sigurojë që kontraktuesit e saj do të mbajnë sigurime të përkohshme, si sigurimi i përgjegjësisë profesionale gjatë ekzekutimit të Projektit. Siguracionin për dëmtim kundrejt palëve të treta në infrastrukturën publike etj.

Neni 10 Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Çdo mosmarrëveshje që lind nga kjo kontratë ose lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet përmes negociatave miqësore. Nëse palët nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen përmes negociatave, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Në rast të zgjidhjes së kësaj Kontrate, palët do të bashkëpunojnë për të siguruar një tranzicion të qetë dhe për të minimizuar çdo humbje. Nëse marrëveshja ndërpritet për shkak të mosrespektimit të afateve të pagesave nga ana e Bashkisë, FSHF do të ketë të drejtë të mbajë shumën e kryer deri në atë moment dhe të ndërpresë menjëherë kryerjen e punimeve.

Neni 11 Amendimet

Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm me një dokument të nënshkruar nga të dyja palët. Çdo ndryshim duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak Përmet.



Neni 12 **Marrëveshja e plotë**

Kjo kontratë përbën të gjithë kontratën midis palëve në lidhje me projektin, objekt marrëveshje dhe zëvendëson të gjitha komunikimet dhe propozimet e mëparshme verbal apo me shkrim. Marrëveshja do të mbetet në afat, deri në dorëzim të objektit të përfunduar.

Neni 13 **Njoftimet**

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera sipas kësaj Kontrate duhet të jenë me shkrim dhe do të konsiderohen se janë dhënë siç duhet kur dorëzohen personalisht, me email ose dërgohen me postë të regjistruar ose të çertifikuar, me marrje në dorëzim, në adresat e mëposhtme:

- a. Për FSHF: Rruga Liman Kaba Nr.5 Tiranë.
Tel: 0035542346601
Email: info@fshf.al
- b. Për Bashkinë Përmet: Sheshi "Abdyl Frashëri", Përmet.
Tel: 0035581322254
Email: info@bashkiapermet.gov.al

Neni 14 **Informacioni konfidencial**

1. Palët duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
2. Palët mund të shkëmbejnë dokumente të tilla, të dhëna ose informacione të tjera deri në masën e kërkuar për zbatimin e kontratës.
3. Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, palët duhet t'i vendosin në dispozicion njëra-tjetrës të gjitha provat dhe informacionin në posedim të tij të cilat kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 15 **Të ndryshme**

Çdo heqje dorë nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 16

Dispozita Përfundimtare

1. Pas përfundimit të punimeve, pronësia e veprës infrastrukturore stadiumi "Durim Qypi" do të mbetet në pronësi të Bashkisë Përmet.
2. FSHF do të ketë të drejtë të përdorë stadiumin "Durim Qypi" për ndeshje dhe aktivitete të organizuara nga FSHF, në koordinim me Bashkinë Përmet.
3. Kjo kontratë nuk mund të transferohet ose ti caktohet palëve të treta pa pëlqimin me shkrim të palës tjetër.

Neni 17

Gjuha e kontratës

1. Kjo kontratë përbëhet nga 6 (gjashtë) faqe (pa përfshirë anekset si : preventivi i punimeve, specifikimet teknike, vendimi i KE, Vendimi i Këshillit Bashkiak të cilat do të jenë pjesë integrale dhe e pandarë e saj) dhe hartohet në dy kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë ligjore e ekzekutive.
2. Pasi u lexua me zë dhe u gjet në përputhje me vullnetin e lirë të palëve, u nënshkrua si me poshtë.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo kontratë do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të saj nga palët dhe miratimit të saj nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Përmet.

PALËT

BASHKIA PËRMET
FUTBOLLIT
KRYETARI
Alma HOXHA

FEDERATA SHQIPTARE E

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Ilir SHULKU